



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Tiranë ___/___/2021

Nr. **Prot.**
Nr. Dok.202003104/6

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave në bashkëpunim me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë për zbatimin e vendimeve gjyqësore për ndihmën juridike të garantuar nga shteti (rasti i shtetasit F.H)*

MINISTRISË SË DREJTËSISË
DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS
Tiranë

Për dijëni: **DHOMËS SË AVOKATISË TË SHQIPËRISË**
Tiranë

Për dijëni: **DHOMËS VENDORE TË AVOKATISË SHKODËR**

Të nderuar,

Sikurse jeni në dijëni, në vëmendjen e Avokatit të Popullit ka qenë miratimi i ligjit nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", po ashtu vënia e tij në zbatim, nxjerrja e akteve nënligjore, ngritja e strukturave të parashikuara nga ligji dhe efektiviteti i tij, në kuadër të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve që shteti t'ua garantojë këtë shërbim.

Për këtë arsye, Avokati i Popullit ka luajtur një rol aktiv të rëndësishëm duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse si: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe Kryeministria.

Po ashtu, është adresuar një rekomandim¹ në Ministrinë e Drejtësisë lidhur me çështjet e vlerësuara për të marrë zgjidhje, sa i përket vënies në funksion të gjithë mekanizmave ligjorë shtetërorë, të parashikuar në ligjin e sipërpërmendur. Çmojmë të evidentojmë faktin se, ky rekomandim është mirëpritur dhe është zbatuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas me të cilën kemi pasur bashkëpunim në vijimësi.

Nga komunikimi shkresor që kemi pasur, jeni informuar se në institucionin tonë është paraqitur një ankesë nga z.F.H, i cili ka përfituar në bazë të vendimit nr.23 (281), datë 15.06.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ndihmë juridike falas dhe përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore.

Fillimisht ju jemi drejtuar për informacion lidhur me rastin përkatës. Me shkresën nr.549/1prot., datë 17.11.2020 është sqaruar se caktimi i avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore, sipas parashikimeve ligjore në fuqi është në kompetencën e Dhomës Vendore të Avokatisë.

Konkretisht, në nenin 24 të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, “Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga avokatët”, si dhe Udhëzimit të Përbashkët nr.18, datë 05.08.2020 “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”, parashikohet se:

“Në rast të pranimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore veprohet sipas rregullave të mëposhtme:

- a) dhoma vendore e avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas parimit të rotacionit;*
- b) dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit, këtij të fundit dhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore”.*

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional, pas komunikimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me shkresën

¹ Nr.K2/E31-4 prot., datë 26.06.2020.

Për më tepër, shih:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandohet%20marrja%20e%20masave%20p%C3%ABr%20garantimin%20e%20aksesit%20n%C3%AB%20drejt%C3%ABsi%20p%C3%ABrmes%20sistemit%20t%C3%AB%20ndihm%C3%ABs%20juridike%20n%C3%AB%20zbatim%20t%C3%AB%20ligjit.pdf>

nr.75/1 prot., datë 30.06.2020, i është drejtuar Dhomës Vendore të Avokatisë Shkodër përmes të cilës i kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës dhe vijimin e procedurës për caktimin e avokatit që do të ofrojë ndihmën juridike dytësore dhe nuk ka marrë përgjigje.

Pas komunikimit të mësipërm me Drejtorinë e Ndihmës Juridike, institucioni i Avokatit të Popullit u është drejtuar Dhomës Vendore të Avokatisë Shkodër dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, duke theksuar se kjo çështje është zvarritur dhe vendimi i gjykatës nuk po zbatohet. Ndaj në këto rrethana, kemi kërkuar bashkëpunim për zgjidhjen e rastit konkret.

Evidentojmë se, nuk ka pasur reagim dhe nuk na është kthyer asnjë përgjigje si nga Dhoma Vendore e Avokatisë Shkodër, ashtu edhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Vlerësojmë se pavarësisht faktit që dhomat e avokatisë nuk janë institucione të administratës publike, por ushtrojnë në rastin konkret një funksion të institucionit përgjegjës bashkarisht me institucionet e tjera shtetërore për ofrimin e një shërbimi, sikurse është ndihma juridike falas. Në këtë kontekst, mungesa e bashkëpunimit me institucionin e Avokatit të Popullit për zbatimin e një vendimi gjyqësor dhe për t'i garantuar shtetasit F.H ndihmë juridike falas në kuadër të procesit të rregullt ligjor, tregon neglizhencë të theksuar.

Në nenin 6 të ligjit nr.111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, përcaktohen shprehimisht institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike, të cilat janë:

- a) Ministri i Drejtësisë;
- b) Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas;
- c) **Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë;**
- ç) gjykatat kompetente;

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas luan rol thelbësor për shërbimet e ndihmës juridike dytësore. Konkretisht publikon listën e avokatëve të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, publikon kontratën tip me avokatët dhe kryen pagesat e tyre.

Gjithashtu kjo strukturë, miraton me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë një projektudhëzim për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, si dhe duhet të lidhë deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

Ndërsa, detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë janë të përcaktuara në nenin 9 të ligjit nr.111/2017, në të cilin parashikohet se ky institucion përgjegjës:

“a) miraton me udhëzim të përbashkët me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;
b) miraton, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, sipas parashikimeve të nenit 24, të këtij ligji, dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga dhomat vendore të avokatisë;
c) brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik, Dhoma Kombëtare e Avokatisë miraton listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe ia përcjell këtë listë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe dhomave vendore të avokatisë. Në hartimin e kësaj liste, Dhoma Kombëtare e Avokatisë mban parasysh, për aq sa është e mundur, përfshirjen e avokatëve të të gjitha specialiteteve dhe niveleve dhe respektimin e barazisë gjinore;
ç) publikon listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;
d) përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas;
dh) kryen detyra të tjera që i caktohen nga ligji.”

Ndërkohë, në rastin objekt shqyrtimi gjendemi përballë situatës së nxjerrjes së një vendimi nga gjykata kompetente e cila ka vendosur ofrimin e ndihmës juridike falas dhe përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore të shtetasit F.H, detyrim i cili ngarkon në mënyrë të drejtpërdrejtë me zbatim Dhomën Vendore të Avokatisë Shkodër.

Në zbatim të ligjit, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka nënshkruar kontratën për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore falas, për Dhomën Vendore të Avokatisë Shkodër, për vitin 2021, me 8 avokatë:

1. Aleks Vathaj
2. Enver Lada
3. Artan Lika
4. Izet Kadana
5. Miranda Ramadani
6. Majlinda Mandja
7. Elvira Jakova
8. Laureta Vathaj

Mbështetur në nenin 24 të ligjit nr.111/2017 përcaktohet: “a) dhoma vendore e avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas parimit të rotacionit; b) dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit, këtij të fundit dhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.”

Nga komunikimi në vijimësi me ankuesin si dhe përfaqësuesin rajonal të institucionit të Avokatit të Popullit në Kukës, jemi informuar se deri aktualisht, vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër i nxjerrë në qershor të vitit 2020 mbetet ende pa zbatuar, duke mos u caktuar një avokat nga Dhoma Vendore e Avokatisë Shkodër, si dhe njëkohësisht duke mos u respektuar afatet ligjore në rastin e shtetasit F.H.

Çmobjmë se jo vetëm miratimi i ligjit nr.111/2017, por bashkëpunimi i të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë ligj, me përgjegjësitë përkatëse është i domosdoshëm për bërjen funksional dhe efektiv të tij.

Pikërisht, me qëllimin e ofrimit të një shërbimi më cilësor, efikas dhe më pranë shtresave në nevojë u hartua ky ligj, duke sjellë ndryshimet strukturore dhe procedurale përkatëse në përfitimin e ndihmës juridike falas, duke parashikuar të gjithë garancitë ligjore nga institucionet përgjegjëse, me qëllim gëzimin nga ana e qytetarëve të të drejtave themelore në mënyrë të barabartë.

E drejta e aksesit në drejtësi u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës.²

Po ashtu në aktet e Këshillit të Evropës është vendosur standardi se ndihma juridike duhet të mundësohet për të gjithë qytetarët që nuk kanë mundësi ekonomike, jo vetëm për mbrojtjen ligjore në proceset gjyqësore, por edhe në rastet e nevojës për këshillim ligjor.³

² Vendimi nr.52, 14.11.2014 i Gjykatës Kushtetuese

Vendimet nr. 17, datë 18.07.2008; nr. 5, datë 06.03.2009; nr. 48, datë 24.09.2014 të Gjykatës Kushtetuese

³ Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës R(81)7 dhe R(93)1 synonin në thelb të tyre zgjerimin e ndihmës juridike falas në të gjitha fazat e proceseve civile, administrative, penale, përfshirjen e organizatave joqeveritare në ofrimin e këshillimit dhe ndihmës juridike, marrjen e masave për reduktimin e tarifave gjyqësore etj.

Ndërsa në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2020 për Shqipërinë vihet në dukje se nevojiten përpjekje të mëtejshme në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit, monitorimin dhe raportimin e progresit për zbatimin e të drejtave të parashikuara në kodet procedurale pas reformës në drejtësi. Skema e ndihmës juridike duhet të zhvillohet më tej drejt hartimit dhe zbatimit të mekanizmit të kontaktit për të gjitha grupet e lidhura.⁴

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”,* si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për avokatin e Popullit”,* i ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”:*

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të nevojshme për bashkëpunim me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë për zbatimin e vendimit gjyqësor nga Dhoma Vendore e Avokatisë Shkodër për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, shtetasit F.H.
- Marrjen e masave të nevojshme për bashkëpunim me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë për zbatimin në vijimësi të vendimeve gjyqësore nga Dhoma Vendore të Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”,* i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Shih Rekomandimin R (81)7: <https://rm.coe.int/168050e7e4>.

Shih Rekomandimin R (93)1: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016804df0ee

⁴ SWD(2020) 354, Bruksel, 6.10.2020.